

## KONTRATË DHURIMI PJESËSH KAPITALI

Sot, më datë 29 tetor 2021 lidhet kjo Kontratë Dhurimi ndërmjet:

**Z. Armand Gjoshi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 11 tetor 1986, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I61051041P, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e “Dhuruesit”,

Dhe

**Znj. Valbona Rezvani**, shtetase shqiptare, lindur në Dukat, Vlorë, më 26.07.1972, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. ID 031550560 dhe Nr. personal H25726047B, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e “Pranuese e Dhurimit”.

Hyrje:

Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi, i cili zotëron 100% të pjesëve të kapitalit në shoqërinë “**Energy Consulting**” SHPK, e regjistruar më datë 29.06.2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NIPT M11829010H, ka vendosur ti dhurojë Pranuesit të Dhurimit 100% të kapitalit të shoqërisë;

Pranuesi i Dhurimit e pranon dhurimin, miratuar parimisht edhe nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.

Për sa më sipër, palët lidhin këtë Kontratë Dhurimi me kushtet e mëposhtme:

### Neni 1 – Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi i transferon me dhurim 100% (njëqind) pjesë kapitali Pranuesit të Dhurimit që e pranon dhurimin.
- 1.2 Transferimi do të kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 2 – Efektet e Transferimit

- 2.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit bëhet pa kundërshtim.
- 2.2 Efektet financiare të transferimit fillojnë të përlllogariten nga data e regjistrimit të Kontratës së Dhurimit.

### Neni 3 – Deklarime dhe Garanci

- 3.1 Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga cdo barrë, hipotekë, apo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.2 Pranuesi i Dhurimit pas transferimit të pjesëve të kapitalit sipas kësaj Kontrate Dhurimi është mbajtës i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve përkatëse, si pjesëmarrja në fitimet e Shoqërisë.
- 3.3 Pranuesi i Dhurimit deklaron se kupton që pjesët e kapitalit janë të lidhura me qenien si ortak në Shoqëri dhe transferimi i tyre tek të tretët i nënshtrohet përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

#### **Neni 4 – Interpretimi i Kontratës**

4.1 Kjo kontratë Dhurimi do të interpretohet duke analizuar përmbajtjen e saj në tërësi. Në çdo rast, nëse ndonjë nen ose fjalë është e paqartë, ajo duhet të shikohet në tërësinë e kësaj kontrate dhe në kuadrin e qëllimeve të të dyja palëve për të lidhur këtë Kontratë Dhurimi.

#### **Neni 5 – Informacioni dhe Dokumentet**

5.1 Informacioni dhe dokumentet në këtë Kontratë Dhurimi janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë.

#### **Neni 6 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

6.1 Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Kontratë Dhurimi do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në rast të kundërt palët do ti drejtohen Gjykatës kompetente shqiptare.


#### **Neni 7 – Të ndryshme**

7.1 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

7.2 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore.

**DHURUESI  
DHURIMIT**

**Z. Armand Gjoshi**

ARMAND GJOSHI: 

**PRANUESI I**

**Znj. Valbona Rezvani**

Valbona Rezvani  
